



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-90
Prishtinë, më 8 shkurt 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 8 SHKURT 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmt Hajrizi, Ismet Hajrullahu, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Shefqet Rexhepi.

Nga Presidenca, Lumnije Murati,
Nga NDI, Rinor Beka,
Nga OSBE, Florjana Shala.
Nga ZCN, Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai i dëshiroi mirëseardhje anëtarit të radhës të Kryesisë Etem Arifi.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 janar 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 janar 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 janar 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 11 shkurtit 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme plenare të mbahet me 11 shkurt 2010, me këtë

R e n d d i t e:

- 2.1 Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 28 janar 2010,
- 2.2 Koha për pyetje parlamentare,
- 2.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
- 2.4 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,
 - 1.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
 - 1.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
- 1.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare,
- 1.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotyësimin e Ligjit për duhanin 02 L-36,

- 2.9 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimi, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarve të lartë publikë.
- 2.10 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike dhe
- 2.11 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Kryesia pas diskutimeve të Jakup Krasniqit, Ibrahim Makollit dhe Ardian Gjinit, për këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që kjo pikë të radhitet për shqyrtim në seancën plenare të 11 shkurtit 2010.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë Transport dhe Telekomunikacion, për Strategjinë e energjisë për periudhën 2009-2018

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, vendosi që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Kryesisë.

3.3 Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ta shqyrtojë propozimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore, dhe Kryesisë t'i paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Riza Smaka për të udhëzuar Qeverinë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-129 për zonat ekonomike

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të jap mendimin lidhur me Mocionin e deputetit Riza Smaka për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-129 për zonat ekonomike.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar të kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në Francë

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i z. Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqës, në Paris, prej 02 - 05 mars 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurin sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.6 Njoftimi me rekomandimin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës i dërgohet Qeverisë së Republikës së Kosovës për veprime të mëtejme, në pajtim me Ligjin.

3.7 Njoftimi me Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e tre (3) deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia u informua me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e tre (3) deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe mirëpret angazhimin e tyre si deputetë të Kuvendit të Kosovës.

3.8 Njoftimi për formimin e Grupit të ri parlamentar “ Për Integritime”

Kryesia u informua me iniciativën e shtatë deputetëve për formimin e grupit të ri parlamentar Për Integritime.

3.9 Kërkesa e Grupit të ri parlamentar Për Integritime, për përfaqësim në Kryesinë e Kuvendit dhe në komisione parlamentare

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori dy përfundime:

P Ë R F U N D I M

Emërimi i anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit është bërë në fillim të mandatit të kësaj legjislature, në seancën konstitutive, në bazë të propozimeve dhe të marrëveshjeve të arritura ndërmjet partive politike apo koalicioneve, sipas vendeve të fotuara ose sipas përfaqësimit të komunitetit.

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që, në bashkëpunim me Grupin Parlamentar për Integritim dhe me Grupin Parlamentar SLS, të identifikojë se në cilat komisione parlamentare anëtarët e këtyre dy grupeve janë të përfaqësuar, përkatësisht në cilat komisione parlamentare duhet të përfaqësohen dhe t’ a informojnë Kryesinë e Kuvendit lidhur me të.

3.10 Njoftimi për skadimin e mandatit të një anëtari të Komisionit të Konkurrencës

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të iniciojë procedurën për propozimin e kandidatit për anëtar të Komisionit të Konkurrencës, në pajtim me Ligjin.
2. Propozimi, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t’i dërgohen Kuvendit, në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

3.11 Njoftimi për skadimin e mandatit një anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të iniciojë procedurën për propozimin e kandidatit për anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me Ligjin.
3. Propozimet, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t'i dërgohen Kuvendit, në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**